



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dispozitat e nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391 të dt. 25.2.2010, dhe propozimit të grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018, të dt. 12.04.2018, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 03.05.2018, miratoi

## **PLANIN**

### **VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS**

#### **I.**

MIRATOHET Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2018.

#### **II.**

Plani vjetor i cekur në pikën I të këtij vendimi, përmban: numrin e mbledhjeve, muajin në të cilin do të mbahet mbledhja e Kuvendit të Komunës dhe pikat - temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit të Komunës.

#### **III.**

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës me përmbajtjen e cekur në pikën II të këtij vendimi, është si në vijim:

##### **1. Muaji janar:**

- Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
- Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa;
- Caktimi i anëtarëve të komisioneve komunale të aksionarëve për ndërmarrjet publike lokale.

##### **2. Muaji shkurt:**

- Vendimi për fillimin e hartimit të Planit zhvillimor komunal "Prishtina 2018-2026";
- Vendimi për fillimin e hartimit të Hartës zonale të komunës së Prishtinës 2018-2026;
- Shqyrtimi raportit vjetor buxhetor për vitin 2017;



- Propozimvendimi për miratimin paraprak të dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);
- Themelimi i Komitetit për Komunitete;
- Themelimi i grupit punues për hartimin e planit vjetor të Kuvendit të Komunës dhe Rregullores së punës së Kuvendit dhe komiteteve;
- Plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës 2018- 2020.

### 3. Muaji mars:

- Përmirësimi i gabimit teknik në pjesën tekstuale të PRRH-së “Kodra e Trimave 1”;
- Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronares Lumnije (Musa) Latifi;
- Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Luan (Ramadan) Hoxha dhe Armend (Ramadan) Hoxha;
- Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Enver (Ali) Aliu dhe Xhemajl (Hasan) Krasniqi;
- Konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës;
- Konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës;
- Konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale;
- Diskutim rreth punimeve të sheshit “Adem Jashari”.

### 4. Muaji prill:

- Plani i veprimit për transparencë;
- Binjakëzimi i kryeqytetit të Kosovës me kryeqytetin “Des Moines” të IOWA-së;
- Shqyrtimi i informatës tremujore financiare të Komunës për periudhën janar - mars 2018;
- Themelimi i KKSB-së;
- Themelimi i komiteteve tjera;
- Shitja e pronës së luajtshme të Komunës.



## 5. Muaji maj:

- Formimi i grupit punues për hartimin e Planit të veprimit për proces transparent të buxhetimit;
- Informatë mbi Qarkoren e parë buxhetore të MF-së;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë për mbjelljet pranverore;
- Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prishtinës;
- Shqyrtimi i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës;
- Informatë për përgatitjen e korrje-shirjeve 2018.

## 6. Muaji qershor:

- Rishikimi i buxhetit për vitin 2018;
- Seancë solemne "11 Qershori - Dita e Çlirimit të Prishtinës";
- Miratimi i Kornizës afatmesme buxhetore 2019-2021;
- Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë për menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve në komunë;
- Informate mbi rolin e drejtorisë në zhvillimin ekonomik dhe të turizmit.

## 7. Muaji korrik:

- Raportimi i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë 2018;
- Shqyrtimi i informatës financiare të Komunës për periudhën prill – qershor 2018;
- Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Prishtinës për vitin 2017;
- Informatë mbi Qarkoren e dytë buxhetore të brendshme komunale;
- Informatë mbi performancën e Komunës, MAPL;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë mbi zbatimin e Planit të mobilitetit;
- Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të vitit shkollor 2017/2018, testit të arritshmërisë dhe testit të maturës.

## 8. Muaji gusht:

**Pushim**



## 9. Muaji shtator:

- Informatë për mbarimin e vitit shkollor 2017-2018 dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2018-2019;
- Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për vitin 2019;
- Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019;
- Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për tatimin në pronë;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale.

## 10. Muaji tetor:

- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën korrik - shtator 2018;
- Informatë për procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje;
- Informatë për ndarjen e bursave për studentë;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë mbi zbatimin e Planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prishtinës;
- Informatë nga drejtorja për të mbjellat vjeshtore.

## 11. Muaji nëntor

- Informatë për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve për sezonin dimëror;
- Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi;
- Informatë për gjendjen në institucionet shëndetësore ( QKMF, QMU, QMF etj.)

## 12. Muaji dhjetor

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019;
- Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë mbi punën e Njesisë së auditimit të brendshëm;
- Informatë mbi punën e Komitetit të auditimit;
- Informatë mbi punën e komiteteve dhe komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike komunale.



**IV.**

Për zbatimin e pikës III të këtij vendimi do të kujdesen: kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive, drejtorët e institucioneve shëndetësore dhe arsimore dhe Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjet publike lokale.

**V.**

Ky plan hyn në fuqi 15 ditë nga dita e protokollimit në Njësinë për administrimin e dokumenteve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-030/06-0105406/18 , më 04.05.2018

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta



*Agim Kuleta*



## **A r s y e t i m**

Kuvendi i Komunës funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë vetëqeverisjen lokale dhe Statutit të Komunës së Prishtinës.

Sipas LVL – së, Kuvendi i Komunës nuk e delegon përgjegjësinë e tij lidhur me marrjen e Vendimit për planin vjetor të punës së tij (neni 40, paragrafi 40.1, pika d).

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 7.3.2018, ka themeluar Grupin punues për hartimin e propozimplanit të Kuvendit të Komunës për vitin 2018.

Grupi punues ka mbajtur takim më 12.04.2018 dhe pas finalizimit të këtij propozimplanit, i njëjti i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratimin e tij.